



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200252/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Kurbin.

Drejtuar: z. Paulin ÇUPI
Shef i Komisariatit të Policisë Kurbin

KURBIN

Për dajeni: z. Vehbi BUSHATI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

LEZHË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Kurbin.

Inspektimi u krye në datën 01.03.2022, sipas planit të inspektimit vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde, rregullave teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Kurbin, z. Paulin Çupi dhe Shefin e Rendit, z. Plarent Lleshaj, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njohën me qëllimin e inspektimit, shefi i Komisarariatit dhe ai i Rendit, informuan grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisarati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Gjithashtu, shefi i Komisarariatit, angazhoi shefin e Rendit dhe përgjegjësin e ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni, që të ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e përgjithshëm të nevojshëm, vijoi takimin me punonjës të përgjegjës të dhomave të shoqërimit, i cili na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të këtyre ambienteve të Komisarariatit të Policisë Kurbin.

Theksojmë se, punonjës të Komisarariatit të Policisë Kurbin me të cilët kontaktuam, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

U inspektuan ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u verifikua dokumentacioni përkatës, në të cilin pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar.

Në Komisariatin e Policisë Kurbin, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, rezultoi se: ¹

- Ishte zbatuar rekomandimi për kryerjen e intervistave me të miturit në konflikt me ligjin, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme të intervistimit, në bazë të gjendjes dhe nevojave të të miturit.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për mirëmbajtjen e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në ambientet e Komisarariatit të Policisë por kishte nevojë tek njëra dhomë për lyrje dhe mbajtje pastër të saj.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se është e nevojshme:

- Marrja e masave të menjëhershme për ndërtimin e plotë të godinës së Komisarariatit Kurbin, sipas kriterëve të parashikuara në Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme dhe bashkëkohore për shtetasit e ndaluar apo shoqëruar, në konflikt me ligjin.

¹ Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Kurbin. K4/I 29-2 prot, datë 30.07.2020

- Marrja e masave të nevojshme për krijimin e zyrës së intervistimit, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, u evidentua gjithashtu, dhe një problematikë në lidhje me godinën e Komisarariatit të Policisë Kurbin, i cili për shkak të dëmtimeve në strukturat e jashtme dhe të brendshme të tyre nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, paraqiste mjaft probleme. Gjithashtu, u informuam se, kishin ardhur specialistë nga Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit, ku kanë bërë dhe një raport konstatimi në lidhje me dëmtimet e godinës. Ata i kishin informuar se, do të rikonstrukturohet me fondet e qeverisë shqiptare dhe të donatorëve të huaj të planifikuara për rindërtimin e qytetit të Laçit, për eliminimin e pasojave të tërmetit, por asgjë nuk është bërë edhe pse ka kaluar më shumë se 2 vite.

Institucioni i Avokatit Popullit kërkon marrjen e masave të menjëhershme të institucioneve përgjegjës për gjetjen e fondeve përkatës për rikonstruksionin sa më parë të Komisarariatit të Policisë Kurbin për të qenë sa më funksional në ofrimin e kushteve të përshtashme të stafit të këtij institucioni në shërbim të qytetarit, por dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje aktet ligjore në fuqi.

Për shkak të situatës të krijuar nga pandemia COVID-19, grupi i inspektimit kontrolloi gjithashtu, masat të cilat ishin marrë për parandalimin e përhapjes së virusit, sigurimin e maskave mbrojtëse dhe disinfektantëve për stafin, por dhe për qytetarët që marrin shërbime në mjediset e policisë, zbatimin e protokollit shëndetësor për ruajtjen e distancimit social dhe fizik të punonjësve të policisë në kontaktet me njëri-tjetrin dhe me qytetarët, si dhe vendosjen e posterave afishues në vende të dukshme me rregullat që duhet të ndiqen për parandalimin e Covid-19. Dezinfektantët për pastrimin e duarve, ishin vendosur në vende të dukshme në ambientet e shoqërimit dhe ishin afishuar materiale informuese për zbatimin e protokollit shëndetësor për parandalimin e kësaj sëmundje apo për ruajtjen e distancës fizike mes njëri-tjetrit dhe me qytetarët.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarariatit të Policisë Kurbin ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika të cilat do të paraqiten konkretisht më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarariatit të Policisë së Kurbin, ambienti i shoqërimit në tërësi ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në një ndërtesë më vete nga godina kryesore e Komisarariatit. Kjo ndërtesë ishte në gjendje të mirë. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, 1(një) dhomë shoqërimi për personat e rritur, 1(një) dhomë për femra dhe 1(një) dhomë për të mitur².

² *Kreu VI, pika 3 e Procedurave Standarde. “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me tavolina dhe stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra nga ana higjeno-sanitare, por njëra kishte nevojë për lyrje dhe për tu mbajtur në vazhdimësi e pastër nga ana higjeno-sanitare. Në këto ambiente nuk kishte sistem ngrohje/ftohje.

Dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të pajisura me tualete brenda apo ngjitur me to. Të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej edhe nga punonjësit e policisë të këtij Komisariati. Në korridorin e dhomave të shoqërimit ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve, që kryheshin nga punonjësit e policisë me të shoqëruarit.

Në lidhje me zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar, në Komisaratin e Kurbin, nuk kishte dhoma (zyra) për marrjen në pyetje/intervistimin e këtyre personave³. Ndërsa për të miturit në konflikt me ligjin ishte krijuar një ambient i veçantë për marrjen në pyetje/intervistim.

Në Komisaratin e Policisë Kurbin, gjatë periudhës 01.01.2022 deri më 01.03.2022, për periudhën 3 mujore ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evindetuar në regjistrin e shoqërimit **56** persona, ku saktësisht **51** shtetas madhor, **2** shtetas të mitur dhe **3** shtetase femra të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë, por nuk u jepet karta e të drejtave në momentin e shoqërimit. **Mekanizmi Kombëtar** kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në Komisarati, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat që këto individë gëzojnë.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes, dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2021 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e Komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

³ *Kreu VI, pika 4/e të Procedurave Standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici".*

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Kurbin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë të Lezhës.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Në Komisariatin e Policisë Kurbin, u konstatua se, regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në Komisariatin e Policisë Kurbin, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁴.

Në këtë Komisarariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi. Në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Nga inspektimi, u konstatua se komisaritati i Policisë Kurbin, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2022 ishte të shoqëruar **2** të mitur në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisariateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin.⁵

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Kurbin, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

⁴ *Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

⁵ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare⁶, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Grupi i inspektimit, evidentoi si një praktikë të mirë në Komisarariat e Policisë Kurbin investimin e realizuar me fondet e World Vision për krijimin e tre dhomave të përshtatura për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin. Ky mjedis përbëhej nga 3 dhoma, të pajisura me të gjitha orëditë e nevojshme dhe komode për qëndrimin ulur të këtyre personave, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës. Këto dhoma ndodheshin në katin e 1 të godinës së Komisarariatit dhe ishin bërë funksionale nga muaji shtator 2020. Ato ishin të pajisura me të gjitha orëditë e nevojshme si tavolina, kolltuqe, bibliotekë për libra, postera informues, kondicioner si dhe ishte e monitoruar me sistemin audioviziv. Në Komisarariat e Policisë Kurbin, ishte trajnuar vetëm 1 specialist për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Laçit, si dhe Bashkinë e këtij qyteti. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar, u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kurbin ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqisnin probleme shëndetësore, ata i shoqëronin në qendrën shëndetësore Laç, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorët e godinës si dhe në ambientet e dhomave të shoqërimit të këtij Komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin/rikonstruksionin e plotë të godinës së Komisarariatit Kurbin, sipas kritereve të parashikuara në Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme dhe bashkëkohore për shtetasit e ndaluar apo shoqëruar, në konflikt me ligjin.
2. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrës së intervistimit, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
3. Marrjen e masave për mirëmbajtjen e kushteve higjeno-sanitare dhe pastërtisë në ambientet e Komisarariatit të Policisë, si dhe lyrjes dhe dezinfektimit të vazhdueshëm të tyre.
4. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe meshkuj, si dhe të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Kurbin.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e paisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkohet të viheni në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI